



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 366 Prot

Tiranë, më 15.12, 2014

VENDIM Nr. 362 datë 12.12.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.12.2014, pasi shqyrtoi "Relacionin Paraprak mbi Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit" në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Historike të qytetit të Lezhës", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, në bashkëpunim me DRKK Shkodër,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Relacionin Paraprak mbi Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit", në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Historike të qytetit të Lezhës", të realizuar deri në këtë fazë.
- II. Punimet për Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit do të ndërpriten në këtë fazë, për t'ja lënë vendin ruajtjes dhe evidentimit të strukturave të zbuluara.
- III. Instituti Monumenteve të Kulturës duhet të bëjë projektin për ruajtjen dhe evidentimin e këtyre strukturave, në mënyrë që ky projekt të integrohet me projektin e "Rehabilitimit të Qendrës Historike të qytetit të Lezhës".
- IV. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO